


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori III, 2017

Tiranë, më 06 Dhjetor 2017: Indeksi i Çmimeve të Importit u ul me 1,7 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016 dhe me 0,8 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2017.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Indeksi i Çmimeve të Importit në tremujorin e tretë 2017 shënoi ulje me 1,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016.

Çmimet e importit të produkteve në aktivitetet e industrisë përpunuese, e cila zë peshën më të madhe në Indeksin e Çmimeve të Importit, kanë shënuar ulje me 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Ndikimin kryesor në këtë rënie e kanë dhënë çmimet e importit të produkteve në aktivitetet “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 4,5 %, “Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 2,2 %, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve” me 1,3 %. Krahasuar me tremujorin e tretë 2016, çmimet e importit të produkteve në aktivitetin “Nxerrja e mineraleve të tjera nga minierat dhe karrierat” kanë shënuar rritje me 0,3 %.

Indeksi i Çmimeve të Importit në tremujorin e tretë 2017 është ulur me 0,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017.

Çmimet e Importit në seksionin “Industria Nxjerrëse” pësuan rënie me 0,7 %, krahasuar me tremujorin paraardhës. Referuar të njëjtës periudhë krahasimi, çmimet e importit në seksionin “Industria Përpunuese” kanë shënuar ulje me 1,0 %. Brenda kësaj industrie ndikimin më të madh e kanë dhënë uljet e çmimeve të importit të produkteve në aktivitetet “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 0,8 %, “Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 0,5 %, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve” me 1,2 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Për publikim 06/12/2017

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2012=100

NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	07- 17	08- 17	09-17	III-17
	Gjithsej	100,0	94,9	95,1	95,2	95,1
B	Industri Nxjerrëse	0,2	93,5	93,5	93,5	93,5
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	93,5	93,5	93,5	93,5
C	Industria Përpunuese	97,4	95,8	95,8	95,7	95,8
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,0	89,5	89,8	89,9	89,7
11	Prodhimi i pijeve	2,3	98,2	98,3	97,4	97,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	5,2	97,4	97,4	97,4	97,4
13	Përpunimi i tekstileve	5,1	110,0	111,8	111,7	111,2
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,4	103,8	104,2	103,9	104,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,4	91,0	90,5	89,4	90,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,3	101,8	101,8	101,8	101,8
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	1,9	93,2	93,1	93,6	93,3
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	80,6	80,6	80,6	80,6
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	10,0	93,4	93,4	93,4	93,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	6,8	95,6	95,4	95,6	95,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	5,0	98,4	98,4	93,6	96,8
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	5,2	90,8	90,8	91,1	90,9
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	2,8	94,4	94,5	94,5	94,5
24	Metallurgjia	6,0	91,1	91,0	91,4	91,2
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,7	100,4	101,6	101,4	101,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,4	95,7	94,0	95,2	95,0
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	4,8	99,0	98,7	99,1	98,9
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	6,4	103,2	103,4	103,6	103,4
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	5,1	107,5	106,2	106,2	106,7
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,2	89,0	90,7	89,4	89,7
31	Prodhimi i mobiljeve	0,7	99,7	98,6	98,8	99,0
32	Industri të tjera p,k,t	1,7	99,9	98,4	99,3	99,2
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	1,5	73,3	81,6	94,2	83,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	1,5	73,3	81,6	94,2	83,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,9	79,1	80,0	79,4	79,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	0,9	79,1	80,0	79,4	79,5

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

%				
NVE	Përshkrimi	Peshat	III - 17 / II- 17	III-17 / III-16
	Gjithsej	100,0	-0,8	-1,7
B	Industri Nxjerrëse	0,2	-0,7	0,3
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,7	0,3
C	Industria Përpunuese	97,4	-1,0	-1,9
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,0	-0,8	-4,5
11	Prodhimi i pijeve	2,3	-0,8	0,3
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	5,2	-1,1	-2,8
13	Përpunimi i tekstileve	5,1	1,2	-0,3
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,4	0,3	-0,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,4	-4,3	-1,8
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,3	-0,7	-1,8
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	1,9	0,2	0,7
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	3,2	2,9
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	10,0	0,8	1,5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	6,8	-0,5	-2,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	5,0	-5,2	-6,2
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	5,2	-5,1	-5,9
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	2,8	-0,4	-1,1
24	Metalurgjia	6,0	-0,1	0,4
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,7	-0,9	-2,0
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,4	0,9	-5,4
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	4,8	-1,0	-0,5
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	6,4	-1,2	-1,3
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	5,1	-0,7	-1,6
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,2	0,7	2,8
31	Prodhimi i mobilie	0,7	1,6	2,3
32	Industri të tjera p,k,t	1,7	-0,3	-0,3
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	1,5	9,8	7,3
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	1,5	9,8	7,3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,9	-2,6	6,4
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	0,9	-2,6	6,4

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun Vendas.

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industria Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe tremujorit të mëparshëm.